

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

### KUALIFIKIMI PROFESIONAL "LLOGARI "

#### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

#### Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Pikët									
Kërkesa	10	11	12	13	14	15	16	17	18
Pikët									
Kërkesa	19	20	21	22	23	24	25	26	27
Pikët									
Kërkesa	28	29	30	31	32	33			
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Rrethoni përgjigjen e saktë. Lakorja e kërkesës në përgjithësi paraqitet : **1 pikë**  
A) Me pjerrësi pozitive  
B) Me pjerrësi negative  
C) Paralele me boshtin vertikale  
D) Paralele me boshtin horizontal
2. Rrethoni përgjigjen e saktë. Kategoritë ofertë dhe sasi e ofruar janë kategori: **1 pikë**  
A) Të njëjta  
B) Të ndryshme  
C) U interesojnë vetëm konsumatorëve  
D) Shprehen ose llogariten vetëm në vlerë
3. Rrethoni përgjigjen e saktë. Kur norma e inflacionit është me një shifër themi se kemi të bëjmë me: **1 pikë**  
A) Hiperinflacion  
B) Inflacion galopant  
C) Inflacion nga kostoja  
D) Inflacion të moderuar
4. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në një ekonomi tregu, punëzënia e plotë nënkupton që: **1 pikë**  
A) Norma e papunësisë të jetë e barabartë me zero për qind  
B) Papunësia të jetë e barabartë me papunësinë strukturore  
C) Papunësia të jetë e barabartë me papunësinë friksionale  
D) Papunësia të jetë e barabartë me papunësinë strukturore +friksionale
5. Rrethoni përgjigjen e saktë. Një prodhues prodhon 10 karrige me çmim pa TVSH 3.000 lekë për copë. Vlera me TVSH për këto karrige është : **1 pikë**  
A) 3.000 lekë  
B) 6.000 lekë  
C) 30.000 lekë  
D) 36.000 lekë
6. Rrethoni përgjigjen e saktë. Një faturë tatimore sipas ligjit në fuqi duhet të lëshohet : **1 pikë**  
A) Vetëm në një kopje  
B) Të paktën në dy kopje  
C) Jo më pak se tre kopje  
D) Jo më shumë se dy kopje
7. Rrethoni përgjigjen e saktë. Periudha tatimore përfshin periudhën : **1 pikë**  
A) 1 Janar – 31 Dhjetor  
B) 1 Janar – 31 Mars  
C) 1 Janar \_ 30 Qershor  
D) 1 Janar \_ 30 shtator
8. Rrethoni përgjigjen e saktë. Një person fizik ka dhënë me qira një matjet me vlerë 200.000 lekë. Tatimi në burim është 15%.Vlera e tatimit në burim është: **1 pikë**  
A) 30.000 lekë  
B) 40.000 lekë  
C) 200.000 lekë  
D) 215.000 lekë

9. Rrethoni përgjigjen e saktë. Një punonjës e ka pagën bruto 53.000 lekë në muaj. Sipas ligjit ç' pjesë e pagës nuk tatóhet për TAP-in: **1 pikë**
- A) 23.000 lekë
  - B) 30.000 lekë
  - C) 33.000 lekë
  - D) 53.000 lekë
10. Rrethoni përgjigjen e saktë Llogaria plus vlerë që konstatohet nga rivlerësimi i aktiveve në Bilancin Kontabël paraqitet në: **1 pikë**
- A) Aktive afatshkurtër
  - B) Detyrime
  - C) Kapital
  - D) Aktive afatgjatë
11. Rrethoni përgjigjen e saktë. Pronari investon në biznes një ndërtesë me vlerë 2.000.000 lekë. Ky veprim sjell: **1 pikë**
- A) Shtim të detyrimeve
  - B) Shtim të kapitali
  - C) Pakësim të kapitalit
  - D) Shtim të të ardhurave
12. Rrethoni përgjigjen e saktë. Llogaria Shpenzime të parapaguara mirëmbajtje me afat 1 vit është llogari: **1 pikë**
- A) Aktive afatshkurtër
  - B) Detyrime afatshkurtër
  - C) Kapital
  - D) Detyrime afatgjatë
13. Rrethoni përgjigjen e saktë. Shoqëria merret me prodhimin e dyerve. Gjatë muajit është përdorur lëndë drusore për prodhimin e dyerve. Ky veprim sjell: **1 pikë**
- A) Debitim të llogarisë bankare
  - B) Kreditimin e llogarisë bankare
  - C) Debitimin e llogarisë Prodhimi
  - D) Kreditimin e llogarisë Prodhimi
14. Rrethoni përgjigjen e saktë. Gjatë likuidimit të detyrimeve ndaj furnitorit brenda termave të kontratës shoqëria ka përfituar skonto për 2.000 lekë. Llogaria "**Skonto te përfituara**" është llogari: **1 pikë**
- A) Aktive
  - B) Detyrime
  - C) Shpenzime
  - D) Të ardhura
15. Rrethoni përgjigjen e saktë. Gjatë vitit 2021 shoqëria ka realizuar 600.000 lekë të ardhura dhe 400.000 lekë shpenzime. Rezultati financiar i vitit 2021 ka sjell: **1 pikë**
- A) Shtim të detyrimeve
  - B) Pakësim të detyrimeve
  - C) Shtim të kapitalit
  - D) Pakësim të kapitalit
16. Rrethoni përgjigjen e saktë. Kosto e mallrave të shitura në inventarizimin e vazhdueshëm gjendet: **1 pikë**
- A) Një herë në muaj
  - B) Mbas çdo shitje
  - C) Mbas çdo blerje
  - D) Një herë në vit

17. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në shoqëritë prodhuese amortizimi i pajisjeve të zyrës së administratës klasifikohet si: **1 pikë**
- Kosto prodhimi
  - Kosto shitje
  - Kosto administrate
  - Kosto indirekte prodhimi
18. Rrethoni përgjigjen e saktë. Të ardhurat nga shitja e mallrave 300.000 lekë, kthim i mallrave nga shitjet 10.000 lekë, Kosto e mallrave të shitura 230.000 lekë. Fitimi bruto është: **1 pikë**
- 60.000 lekë
  - 70.000 lekë
  - 310.000 lekë
  - 240.000 lekë
19. Rrethoni përgjigjen e saktë. Llogaria Humbje-Fitim i pashpërndarë në Bilancin Kontabël paraqitet në: **1 pikë**
- Aktiv afatshkurtër
  - Kapitali i vet
  - Detyrime
  - Aktive afatgjatë
20. Rrethoni përgjigjen e saktë. Kosto e lëndës së parë e përdorur në prodhimin e produkteve të gatshme është kosto: **1 pikë**
- Variabël
  - Fikse
  - Mikse
  - Gjysmë fikse

21. Supozojmë se kërkesa për produktin X jepet nga tabela e mëposhtme:

- Përcakto ekuilibrin e tregut  $P_e=Q_e=$  **1 pikë**
- Argumento se për cilat çmime, tregu është në mungesë oferte **1 pikë**
- Argumento për cilat çmime, tregu është me tepriçë oferte **1 pikë**

Çmimi	Sasia e kërkuar	Sasia e ofruar
500	3000	600
600	2800	900
700	2100	1200
800	2000	1300
900	1500	1500
1000	1400	1700
1200	1100	2000
1500	1000	2300

22. Plotësoni kërkesat e mëposhtme :

3 pikë

A) Tregoni pse lakorja e kërkesës ka pjerrësi rënëse

---

B) Çfarë tregon pjerrësia rënëse e lakores së kërkesës

---

C) Tregoni çfarë sjell një ndryshim i shijeve të konsumatorit për një të mirë ose shërbim

---

23. Plotësoni kërkesat e mëposhtme :

3 pikë

A) Çfarë shpreh oferta e parasë?

---

B) Me çfarë matet oferta e parasë?

---

C) Çfarë është një agregat monetar?

---

24. Evidentoni më poshtë

A) Dy nga rastet kur ndërmarrja kërkon ç'regjistrimin si subjekt për TVSH-në:

2 pikë

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

B) Periudhën kur një ndërmarrje duhet të regjistrohet si subjekt për TVSH-në:

1 pikë

1. \_\_\_\_\_

25. Plotësoni kërkesat e mëposhtme

3 pikë

A) Çfarë është evazioni fiskal ?

---

B) Ku ndikon evazioni fiskal?

---

C) Çdo të thotë kalim në regjistrin pasiv i personit të tatueshëm?

---

26. Regjistrimi për efekte fiskale pranë Drejtorisë së përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve kryhet nëpërmjet disa dokumenteve të përcaktuara. Evidentoni më poshtë tri prej tyre:

3 pikë

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

3) \_\_\_\_\_

27. Shoqëria "Drita" gjatë muajit prill 2022 ka kryer këto veprime ekonomike:

- Ka shitur mallra me arkëtim të mëvonshme për 300.000 lekë, TVSH 20%, termat e kontratës 2/10, n/30.
- Ka blerë mallra me pagesë të mëvonshme 100.000 lekë, TVSH 20%, termat e kontratës 3/10, n/60
- Gjatë muajit janë kthyer mallra nga klienti si jashtë standardit nga shitjet e bëra 20.000 lekë, TVSH 20%.
- Janë arkëtuar në llogarinë bankare të drejtat për mallrat e shitura brenda termave të kontratës duke përfutur skonton. Shoqëria përdor inventarizimin periodik.

Kërkohet:

- Të regjistrohet shitja e mallrave 1 pikë
- Të regjistrohet blerja e mallrave 1 pikë
- Të regjistrohet kthimi I mallrave nga shitjet 1 pikë
- Të regjistrohet arkëtimi i të drejtave nga klientët. 1 pikë

Ditari i përgjithshëm

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi

28. Për vitin 2021 shoqëria ka kryer këto veprime ekonomike:

- 01.01.2021 ka blerë një Mjet Transporti me vlerë 240.000 lekë, me pagesë të mëvonshme. Afati i përdorimit 10 vjet.
- Në 01.04.2021 është shitur një kompjuter me arkëtim të mëvonshëm me këto të dhëna :Kosto fillestare 60.000 lekë, amortizimi i akumuluar 30.000 lekë, çmimi i shitjes 20.000 lekë .
- Në 31.12.2021 regjistrohet amortizimi i Mjetit të Transportit

Kërkohet:

- Të regjistrohet blerja e Mjetit të Transportit 1 pikë
- Të regjistrohet shitja e kompjuterit 1 pikë
- Të regjistrohet amortizimi i Mjetit të Transportit 1 pikë

Ditari i përgjithshëm

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi

29. Për vitin ushtrimor 2021 nga librat e kontabilitetit kemi këto të dhëna:

- Të ardhurat nga shitja 2.000.000 lekë
- Kosto e mallrave të shitura 1.200.000 lekë
- Shpenzimet operative 300.000 lekë.
- Shpenzimet e panjohura (të pa zbritshme 100.000 lekë)
- Norma e tatim fitimit 15%

Kërkohet:

- |    |  |        |
|----|--|--------|
| 1. | Të llogaritet fitimi bruto për vitin 2021        | 1 pikë |
| 2. | Të llogaritet fitimi neto para tatimit           | 1 pikë |
| 3. | Të llogaritet tatim fitimi faktik për vitin 2021 | 1 pikë |

30. Sipas librave të kontabilitetit në dt. 31.12.2021 kostoja fillestare e ndërtesës është 1.000.000 lekë, amortizimi i akumuluar 200.000 lekë. Vlera e tregut 1.500.000 lekë.

Kërkohet :

- |    |  |        |
|----|--|--------|
| 1. | Të llogaritet vlera neto e ndërtesës                 | 1 pikë |
| 2. | Të llogaritet diferenca e rivlerësimit të ndërtesës. | 1 pikë |
| 3. | Të regjistrohet rivlerësimi i ndërtesës              | 1 pikë |
| 1. | _____  |        |
| 2. | _____  |        |
| 3. | _____  |        |

Ditari i përgjithshëm

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi

31. Sipas listë-pagesës së muajit maj 2022 kemi këto të dhëna për pagat e punonjësve:

- Paga bruto 2.000.000 lekë,
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që paguan punëmarrësi 250.000 lekë,
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që paguan punëdhënësi 300.000 lekë,
- TAP-i 150.000 lekë.

Kërkohet:

- Të regjistrohen pagat e punonjësve për muajin maj **1 pikë**
- Të regjistrohen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që paguan punëdhënësi **1 pikë**
- Të regjistrohet likuidimi i pagave nga llogaria bankare **1 pikë**

#### Ditari i përgjithshëm

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi

32. Për vitin 2021 shoqëria ka paguar nga llogaria bankare tatim fitimit e parashikuar 100.000 lekë. Fitimi faktik për vitin 2021 është 2.000.000 lekë. Norma e tatim fitimit 15%

Kërkohet :

- Të regjistrohet pagimi i tatim fitimit të parashikuar **1 pikë**
- Të llogaritet tatim fitimi faktik për vitin 2021 **1 pikë**
- Të regjistrohet tatim fitimi faktik **1 pikë**

#### Ditari i përgjithshëm

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
1.			

2. \_\_\_\_\_

#### Ditari i përgjithshëm

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi
3.			



33. Për muajin maj kemi këto veprime në lidhje me TVSH.

- a) Janë blerë mallra me pagesë të mëvonshme 40.000 lekë, TVSH 20%
- b) Janë shitur mallra me arkëtim të mëvonshëm 60.000 lekë, TVSH 20%
- c) Në dt. 31.05.2021 të rregullohen marrëdhëniet me shtetin për TVSH.

Kërkohet:

1. Të regjistrohet blerja e mallrave
2. Të regjistrohet shitja e mallrave
3. Të regjistrohet rregullimi i TVSH.

1 pikë

1 pikë

1 pikë

**Ditari i përgjithshëm**

Data	Përshkrimi i veprimit	Shuma debi	Shuma kredi